

KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES


Nr. 06, datë 26.02.2021

Për miratimin e “Pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2 dhe 3, të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, dhe nenit 62, pika 1 dhe pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 7, pika 6, të nenit 8, pika 2, shkronja “l” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e pasqyrave financiare të audituara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Autoritetin



KËSHILLI DREJTUES

Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar